

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit Artan Abrashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 19/02/2019 Nr.020-121
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Planit Nr.001/011-0015502 të Veprimit për Transparencë në Komunën e Prizrenit për vitin 2019	
Lloji i aktit:	Plan Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Planin Nr.001/011-0015502 të Veprimit për Transparencë në Komunën e Prizrenit për vitin 2019
I miratuar më datë: 31/01/2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07/02/2019


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Plani Nr.001/011-0015502 të Veprimit për Transparencë në Komunën e Prizrenit për vitin 2019	<p>Ky plan nuk është në përputhje me Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna. Vendim përmban në preambulë bazën ligjore, "Udhëzim Administrativ Nr.01/2015 për Transparencë në Komuna" i cili është shfuqizuar me Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, i nënshkruar nga Ministri i MAPL-së me datë, 24.12.2018.</p> <p>Gjithashtu, plani është në kundërshtim me nenin 15, të Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, ku sqaron se: "Komunat obligohen të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë në komunë, dhe pas miratimit në kuvendin e komunës, i njëjti publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës".</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Mytahir Haskuka, gradonačelnik Opštine Prizren Artan Abrashi, predsedavajući Skupštine opštine Prizren	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini	
Preko: <i>Za</i>	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>B.F. Todosijević</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretara MALS-a <i>Rozafa Ukimeraj</i>	
Od:	Venera Çerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS <i>Venera Çerkini</i>	Datum, 19.02.2019. Br.020-121
Predmet:	Zahtev za reviziju akta opštine Prizren	
Vrsta akta:	Odluka skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i Ministarstva, odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Plan Br.001/011-0015502 delovanja za transparentnost u opštini Prizren za 2019 godinu
Usvojena dana, 31.01.2019. godine
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 07.02.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog sadržaja akta opštine, procenjuje da je isti u suprotnosti sa zakonskim odredbama na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisanje u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti.
1.	Plan Br.001/011-0015502 delovanja za transparentnost u opštini Prizren za 2019 godinu	<p>Ova plan nije u saglasnosti sa sa Administrativnim uputstvom MALS-a br.04/2018 za transparentnost u opštinama. odluka u svom uvodu sadrži zakonsku osnovu "Administrativno uputstvo br.01/2015 za transparentnost u opštinama" koja je ukinuta sa Administrativnim uputstvom MALS-a br.04/2018 za transparentnost u opštinama potpisanog od strane ministra MALS-a dana, 24.12.2018.</p> <p>Takođe, plan je u suprotnosti sa članom 15, Administrativnog uputstva MALS-a br.04/2018 za transparentnost u opštinama, gde se navodi da: "Opštine se obavezuju da izrađuju četvorogodišnji akcioni plan za transparentnost u opštini i nakon usvajanja od strane skupštine opštine, isti se objavljuje na zvaničnoj web stranici opštine".</p>

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od gradonačelnika i Skupštine opštine traži da preduzimaju konkretne mere kako bi aat opštine uskladile za zakonskim odredbama na snazi i u vremenskom roku od 30 dana, od dana primanja zahteva za razmantranje akta opštine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za bilo koje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

001-011-0015502/06-02-2019

HYRESHË LILKONNATIVE
REPUBLICAN OFFICE FOR LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION
QEVERIA E KRYESORË E JUHUT KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracione
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 07-02-2019

Numri i gjenerimit	Ku i Llogaritet	Shifra	Vlera
-07-	020-	121	



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledivesi

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1, 2, pika d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, nenit 11, të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2015, për Transparencë në Komunë, nenit 27 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, dt.15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit të Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Prizrenit, për vitin 2019, të propozuar nga kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2019, miratoi këtë:

PLAN TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË NË KOMUNËN E PRIZRENIT PËR VITIN 2019

Neni 1

Miratohet Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Prizrenit, për vitin 2019.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi, do të jetë edhe Plani i Veprimit për Transparencë në Komunë, për vitin 2019.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës përmes Zyrës për Komunikim me Publikun në Komunë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/011-0015502


Më: 31 janar 2019

Prizren





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



001-011-0015502/06.02.2019



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E PRIZRENIT PËR VITIN 2019

JANAR-DHJETOR
2019

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJËN E TRANSPARENCËS NË KOMUNË

Hapat konkretë, që Kuvendi i Komunës së Prizrenit do të ndërmarrë në funksion të përmbushjes së Planit të Veprimit dhe rekomandimeve të ekzekutivit të Komunës përfshijnë objektivat si në vijim:

1. Objektivi i parë i përcaktuar në këtë plan ka të bëjë me mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve tjera. Në këtë kuadër parashikohet:

- 1.1. Njoftim për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve përmes ueb-faqes zyrtare, medieve lokale, të shkruara dhe elektronike, rrjeteve sociale, mbi vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes me agjendë të punës.
- 1.2. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe zyrës për komunikim me qytetarë, së paku 7 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes.

2. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.

- 2.1 Njoftim për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës përmes ueb-faqes zyrtare, medieve lokale të shkruara/elektronike, rrjeteve sociale mbi vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes me agjendë.
- 2.2. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe zyrës për komunikim me qytetarë.

3. Konsultimi me publikun, ku parashikohet të këtë:

- 3.1. konsultime për buxhet,
- 3.2 konsultime për planin/strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal,
- 3.3. konsultime për planifikim hapësinor,
- 3.4. konsultime për investime,
- 3.5. konsultimi për të hyra komunale dhe
- 3.6. konsultimi për çështje tjera në interes të përgjithshëm.
- 3.7. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe zyrës për komunikim me qytetarë, së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në ueb-faqe zyrtare të komunës, në medie lokale të shkruara dhe elektronike, në rrjete sociale si dhe në vendet e frekuentuara në qytet dhe 74 fshatra.

4. Takimet me publikun, ku parashikohet:

- 4.1. Komuna do të mbajë së paku dy takime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilat takime mund të marrë pjesë secili qytetar apo organizatë me interes në Komunë,
- 4.2. Përveç këtyre dy takimeve me qytetarë, Komuna mund të mbajë edhe takime tjera me publikun që do të shqyrtohen objektivat e parapara në pikën tre (3) të këtij Plan veprimi.

4.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga kabineti i kryetarit së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në ueb-faqen zyrtare të komunës, në media, vende të frekuentuara si dhe në rrjete sociale (FB).

5. Takimet dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ, dhe gazetarë.

5.1. takime në formë debati me qytetarë,

5.2. takime pyetje dhe përgjigje,

5.3. intervista, konferenca për media dhe

5.4. Kryetari i Komunës cakton një ditë brenda javës që në zyrën e tij të ketë takime me qytetarë.

5.5. Aktivitetet në nenin 5 : Behën të ditura nga shefi i kabinetit të kryetarit dy javë para, përmes zyrës për komunikim të Kryetarit të Komunës.

6. E drejta e qasjes në dokumente publike.

6.1. Kërkesa për qasje në dokumente publike, trajtohet nga secili organ i Komunës që posedon dokumentin e kërkuar duke mbikëqyr informatën.

6.2. Organi komunal ndihmon kërkuesin për qasje në dokument publik aq sa është e mundshme për të identifikuar dokumentin e kërkuar dhe trajtimi bëhet në mënyrë të barabartë.

6.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga zyrtari i caktuar nga Organi brenda (7) ditësh dhe mund të vazhdohet deri në 15 ditë.

6.4 Njësia/zyrtari për komunikim me qytetarë bën pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave dhe i adreson në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-2015 për Qasje në Dokumente Publike të kërkuesi.

6.5 Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrihen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike .

7. Shqyrtimi i kërkesave për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet.

7.1. Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të trajtohen drejtpërdrejtë apo përmes kërkesave me shkrim,

7.2. Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej 60 ditësh.

7.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit.,

8. Publikimin e akteve komunale.

8.1. Të gjitha Rregulloret, Vendimet dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilit nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhet publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ë.

8.2. Të gjitha këto akte nënligjore dhe dokumentet tjera publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës, në vendet e frekuentuara brenda Komunës brenda 15 ditësh pas regjistrimit në MAPL-ë, ndërsa dokumentet tjera pas hyrjes në fuqi.

8.3 Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit.

9. Freskimin e faqes zyrtare të Komunës.

9.1 Mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ nr.01/2015.

9.2 Përgjegjësia për mirëmbajtjen e ueb faqes së Komunës është e Zyrës për Informim dhe Zyrës së IT-së.

10. Qasjen e shërbimeve për qytetarë në mënyrë transparente dhe të shpejtë.

10.1 Lëshimi e certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, dëshmi që personi është gjallë, dëshmi për vdekje, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve etj.

10.2 Të gjithë formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve sipas pikës 10.1 duhet të publikohen në ueb-faqen zyrtare ku qytetari të ketë qasje dhe informata për realizimin e të drejtës së tij.

10.3 Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese. Ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse zyra e IT-së dhe Zyra e Informimit.

11. Prokurimin transparent. Në këtë kuadër parashikohen:

11.1 Njoftimi për kontratë,

11.2 Njoftim për dhënien e kontratës,

11.3, Njoftim për konkurs të projektimit,

11.4, Njoftim për anulim,

11.5 Njoftim për vazhdimin e afatit

11.6 Njoftim për nënshkrimin e kontratës

11.7 Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është Zyra e Prokurimit, ndërsa për publikimin e dokumenteve të lartshënuara është Zyra e IT-së.

11.8 Njoftimet nga fusha e prokurimit bëhen publike në ueb-faqen zyrtare të Komunës

12. Procedurat e punësimit transparent për qytetarë.

12.1 Shpallja e konkurseve,

12.2 Njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve,

12.3 Njoftimi për anulimin e konkursit,

12.4 Rishpallja, apo vazhdimi i konkursit,

12.5 Avancimet brenda institucionit,

12.6 Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit të shërbimit civil është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre Zyra e Informimit.

12.7 Publikimi i të gjitha procedurave në shërbimin civil publikohen në ueb- faqe zyrtare të komunës, në objektin e Komunës, në media lokale të shkruara dhe atyre elektronike.

Publikimi duhet të jetë edhe te institucionet përgjegjëse për shërbimin civil.

13. Rritja e bashkëpunimit dhe besimit me shoqërinë civile dhe publikun për hartimin e akteve në Komunë. Për të përmbushur këtë objektiv, plani i veprimit parashikon ndër të tjera:

13.1 Ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara etj., të cilët në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë do të kenë në qendër të vëmendjes problematikat e këtyre grupeve.

13.2 Organizimin e takimeve me shoqërinë civile për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit.

13.3 Përmirësime sipas nevojës në Rregulloren e Kuvendit për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë për bashkëpunimin dhe qasjen e organizatave të shoqërisë civile në punimet e Kuvendit të Komunës.

13.4 Ndhimja tjetër për organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë.

13.5 Publikimi i projekti-akteve në faqen e internetit, si dhe propozimeve përkatëse.

14. Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Komunës.

14.1 Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetin vjetor komunal.

14.2 Caktimi i pikave të veçanta në seanca të KK-së për pyetje drejtuar ekzekutivit për çështje të caktuara me interes publik.

14.3. Përfshirja e raporteve të ndryshme të institucioneve dhe organizatave që lidhen me planin e veprimit të punës së Kuvendit.

15. Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit dhe Komunës si tërësi.

15.1 Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës.

15.2. Rritjen e kapaciteteve për shërbimin e teknologjisë së informacionit.

15.3 Sigurimin e buxhetit nga donacionet për kompensimin e një numri të caktuar të stafit këshillëdhënës për Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e KK-së etj.

16. Numeracioni pa pagesë për t'iu dhënë qytetarëve njoftime lidhur me shërbimet që i ofron komuna si dhe për paraqitjen e parregullësive apo vërejtjeve të qytetarëve dhe e-mail-it zyrtar të Komunës.

16.1 Përmes këtij numeracioni, i cili do të jetë në shërbim 24 orë për qytetarët, do të kenë mundësinë të paraqesin kërkesat dhe ankesat e tyre lidhur me qeverisjen lokale dhe për qëllime të tjera që janë në interes të përgjithshëm.

16.2 Numeracioni do të jetë në mbikëqyrje të Drejtorisë së Administratës Komunale.

16.3. Po ashtu në shërbim për qytetarët do të jetë edhe e-mail adresa zyrtare, ku qytetarët mund të shkruajnë: komuna.prizren@rks-gov.net

17. Plani i transparencës mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës.

Shënim zyrtar: Ky plan i veprimit për transparencë në Komunën e Prizrenit për vitin 2019, është miratuar në seancën e mbajtur më 31 janar 2019, të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi

